

Konsultimet lokale me të rinjtë

Daruvar, Kroaci

27. mars 2010.

Konsultimet me të rinjtë janë organizuar nga Qendra për zhvillim të shoqërisë civile – Delfin nga Pakraci si dhe nga Dokumenta nga Zagrebi (Kroaci). Në konsultime kanë marrë pjesë më shumë se 40 pjesëmarrës dhe pjesëmarrëse. Ligjërues ishin Mirjana Billopavilović, (Delfin, Pakrac) Eugen Jakovčić (Dokumenta, Zagreb), Darija Marić (Dokumenta, Zagreb), Cvijeta Senta (Qendra për studime të paqes, Zagreb), Marko Veličković (Qendra për zhvillim të resurseve civile, Nish, Serbi) dhe Ivan Novosel (Legalis, Zagreb). Konsultimet janë përcjellë nga mediat dhe në emisionet e tyre informative reportazhat mbi konsultimet kanë emituar NET televizioni (televizioni i pavarur, Kutina), HRT (Radio Televizioni Kroat) në emisionin Panorama e Komunave dhe radio lokale –Radio Daruvar.

Opinionet, propozimet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve:

Është me rëndësi që të arrihet konsensusi.

(...) shumë [po më] pëlqen kjo iniciativë dhe ideua që të ndërtohet një farë e vërtete mbi të cilën edhe njëra e edhe tjetra palë do të arrijnë konsensus. Pra, O.K. ballafaqimi me disa emra dhe mbiemra, çka kishit thënë ju që këta njerëz nuk janë as Serb e as Kroat por njerëz që kanë kryer krime. Por, është me rëndësi që të vërtetohen faktet mu për arsye të ngushtimit të hapësirës, manipulimeve dhe gënjeshtreve ngase duhet ndërtuar nga themeli. Nuk mund të mbrohesh me një farë lloji të komunikimit të jo dhunshëm nëse nuk ekziston themeli në mënyrë që marrëdhëniet të jenë të spastruara ku nuk do të ketë mohime të eksperiencës tënde traumatike. (Emina Ogrizek, Daruvar, Konsultimet lokale me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Është me rëndësi edukimi i njerëzve që të respektojnë njëri tjetrin dhe t'i respektojnë dallimet

Unë nuk dëshiroj që të mbyllem sytë dhe që të harrohet se çka ka ndodhur, por kur është fjala për rininë, mendoj se mund të bëhet shumë më shumë përmes edukimit joformal dhe duke i mësuar njerëzit që të respektojnë njëri tjetrin dhe t'i respektojnë dallimet. Shoqëria ime është e tillë sa që unë nuk kam rast të shoh urrejtjen. (Jelena Kolesarić, SOS Virovitica, Kroaci, Konsultimet lokale me të rinjtë, Daruvar, Kroaci 27.mars 2010).

Duhet sensibilizuar ata Kroatë që kanë pikëpamje të ashpëra

Kemi dy fqinj që janë të papërshtatshëm, sinqerisht. Kroatë të mëdhenj për shembull të themi. Por kësi lloj njerëzish ka, dhe unë mendoj se duhet shkuar jo vetëm kah njerëzit që kanë pikëpamjet më të buta, të cilët mund t'i përfitosh por duhet shkuar kah ata të tjerët për t'i

sensibilizuar për diçka. (Karolina Melnjak, Zagreb, Kroaci, Konsultimet me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Ka njerëz që janë aqë të fort në pikëpamjet e tyre dhe në këtë çështje duhet punuar për ndryshime. Duhet synuar që të ndryshohet diçka. Gjithashtu duhet marrë në konsiderim edhe luftëtarët ngase shumica e këtyre njerëzve kanë shkuar në luftë në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare. (Karolina Melnjak, Zagreb, Kroaci, Konsultimet me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Duhet pasur kujdes gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të KOMRA-së, dhe të tentohet të përzgjidhen ekspertët

Dhe duhet pasur shumë kujdes gjatë themelimit të këtij komisioni. Ideja është super dhe për çdo lëndatë por duhet pasur kujdes gjatë përzgjedhjes së njerëzve, të juristëve, të sociologëve duhet angazhuar me të vërtetë ekspertët dhe të sigurohet që grupet e interesit të mos ndikojnë në ta. (Karolina Melnjak, Zagreb, Kroaci, Konsultimet me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Është me rëndësi që komisioni të ketë selitë lokale dhe selinë qendrore por nuk është me rëndësi se ku.

Thjeshtë për hir të çështjeve organizacionale, ndoshta ndonjë filiale rajonale ose ashtu diçka në secilin shtet, në kryeqytete apo diku tjetër. Por sipas mendimit tim duhet ekzistuar një vend ku do të jetë i vendosur komisioni, e ndoshta nuk është me rëndësi që të jenë në secilin shtet ngase kuptimi është që t'i mbledhim të gjitha këto shtete dhe të jemi të gjithë të njëjtë, apo jo? Është me rëndësi vetëm t'i vërtetojmë faktet, ndërkaq nuk është me rëndësi se ku do të jetë qendra. Po, unë jam plotësisht për sistemin e centralizuar. (Una Kociper, Zagreb, Kroaci, Konsultimet me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Unë jam për sistem të decentralizuar. Mendoj se duhet ekzistuar një lloj institucioni kulmor, por nga decentralizimi fillon demokracia. Po që se kjo do të jetë nën njëfarë strukture të centralizuar atëherë nuk besoj. (Karolina Melnjak, Zagreb, Kroaci, Konsultimet me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Selia qendrore nuk është e domosdoshme

(...) mendoj se sot jemi mjaftë të rrjetëzuar dhe mund ti ndajmë në mes veti të dhënat dhe t'i përpilojmë raportet e përbashkëta, e nëse do të publikohet libri, atëherë do të ishte libri i cili ka të bëjë me nënshkrimet e të gjitha shoqatave të cilat e kanë punuar bashkërisht librin, prandaj nuk di pse na nevojitet që të ekzistojë ndonjë vend qendror për mbledhjen e të dhënave. (Tatjana Petroviq, Zagreb, Kroaci, Konsultimet lokale me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars.2010).

Përkatësia fetare dhe etnike e anëtarëve të komisionit nuk duhet të jetë me rëndësi.

(...) A është me rëndësi përkatësia fetare dhe etnike e anëtarëve të komisionit . Në parim nuk do të duhej të jetë me rëndësi ngase ata që marrin pjesë në kësi lloj komisioni dhe paragjykohet se ju intereson e vërteta dhe faktet mbi këtë çështje kështu që gjëra të tilla nuk do të duhej të jenë të rëndësishme, por prapë nga ana tjetër ndoshta do të ishte mirë që të jenë disa përfaqësues nga secila pjesë e rajonit kështu që pikëpamjet e ndryshme lidhur me këtë çështje të jenë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë. (Lucija Zore, Zagreb, Kroaci, Konsultimet lokale me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Komisioni duhet të përbëhet nga ekspertë, eventualisht të huaj.

(...) mendoj se komisioni duhet të jetë i përbërë nga ekspertë, këtu shkruan pyetja se a duhet që në komision të ketë të huaj? Unë personalisht nuk do të kisha pasur asgjë kundër ngase ndoshta atëherë opinioni do të ishte edhe më objektiv ngase vjen nga një anë e cila nuk është e kyçur në mënyrë direkt në konflikt. Pse ekspertët? Thjeshtë nga shkak se njeriun që duhet operuar nuk do t'a dërgoni te dikush që vetëm se dëshiron të jetë mjek, por natyrisht, do t'a dërgoni te kirurgu. Gjithashtu besoj se në komision duhet janë njerëzit të cilët ndoshta kanë një nivel profesional mbi këtë çështje, e natyrisht që të gjithë të tjerët të marrin pjesë në mbledhjen e të dhënave, por prapë se prapë një trup profesional ishte dashur të vendos në fund. (Mirna Bartulloviq, Zagreb, Kroaci, Konsultimet lokale me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Duhet hulumtuar rolin e mediave

Mendoj se në parim duhet të merremi me të gjithë. Pra, duhet që të merremi me individ, dhe këtu mendoj se duhet shkuar më gjerësisht dhe se kjo mundet të arrihet. Nëse do të dorëzohen aktet e individëve atëherë në të njëjtën mënyrë mund të dorëzohen edhe aktet e mediave (...). Kjo do të thotë se duhet aq sa është e mundur të hulumtohen mediat dhe institucionet. Por para së gjithash sipas mendimit tim, individët. (Una Kociper, Zagreb, Kroaci, Konsultimet lokale me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

(...) mendoj, ndoshta do të duhej që të përqendrohemi në mediat nga se ato janë ato që më së shumti krijojnë pamjen mbi gjendjen e përgjithshme. Dhe disi më duket se sot ekziston ky trend d.m.th. mosekzistimi i një lloj përgjegjësie për informata të cilat shpërndahen përmes mediave, bile edhe atyre zyrtare pra atyre shtetërore. (Mirna Bartulloviq, Zagreb, Kroaci, Konsultimet lokale me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Duhet diskutuar ngjarjet nga e kaluara më e largët ngase po manipulohet me to

Ndoshta me të vërtetë duhet të merremi me çështjet e Luftës së dytë botërore, të Jasenovcit, dhe Bleiburgut ngase është diçka çka politikisht shfrytëzohet shumë. Me këto çështje manipulohet dhe është një çështje mjaftë e paqartë e edhe të gjitha këto tregime të mëvonshme nga vitet e

nëntëdhjeta të cilat janë shitur shumë mirë, të cilat janë futur gjithkrah dhe ngrehin rrënjët nga këto. Tani parashtrohet pyetja se a duhet diskutuar atë pjesë që më pastaj të sqarohet edhe pjesa e dytë. Por nuk e di se a mundet një komision në tre vite të kryej tërë këto punë. Mendoj se nuk mundet. (Lucija Zore, Zagreb, Kroaci, Konsultimet lokale me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Është me rëndësi institucionalizimi i procesit i cili do të përfundoj me ndryshime në libra shkollor.

(...) mendoj se çështja kyçe është që komisioni të themelohet dhe të ekzistoj një lloj institucionalizimi dhe që në fund të marrim njëfarë letre të mbi krejt këtë tregim përkatësisht ndonjë dokument i cili do të jetë relevant dhe nëpërmes të cilit do të ndryshohen gjërat në librat shkollor. Kjo gjë më duket më e rëndësishme. (Una Kociper, Kroaci, Konsultimet lokale me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Është me rëndësi që të shënojmë se çka ka ndodhur me të vërtetë në mënyrë që mos të ndodhë që ngjarjet e tilla të përsëriten.

Kjo është një iniciativë super dhe është super të shënojmë gjërat, të provojmë të shënojmë të vërtetën, për diçka çka ka ndodhë me të vërtetë në mënyrë që këto ngjarje të mos ndodhin prapë më vonë ngase kjo është e vetmja mënyrë për rritje dhe zhvillim. (Tatjana Petroviq, Konsultimet lokale me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Vërtetimi i fakteve i pamundëson manipulimet

(...) mendoj se është me rëndësi që të vërtetohen faktet ngase atëherë më nuk do të jetë e mundur që të manipulohet me ato, dhe do të zvogëlohet hapësira për gjëra të tilla. (Lucija Zore, Konsultimet lokale me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Nga shkaku i ngjashmërisë së vuajtjeve në vende të ndryshme do të ishte me vlerë që njerëzit të lidhen ndërmjet veti dhe të shohin se sa janë të ngjashëm sa i përket fatit të cilin së bashku e ndajmë

Mendoj se i`a vlen pa marrë parasysh se në fund a do të krijohet njëfarë komisioni, (...) nga shkaku i ngjashmërisë së vuajtjeve në vende të ndryshme rajonale. Që të lidhen njerëzit ndërmjet veti dhe që të shohin se sa janë të ngjashëm sa i përket fatit të cilin së bashku e ndajmë në një mënyrë. (Emina Ogrizek, Konsultimet lokale me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).

Mënyra më e mirë është që të shkohet nëpër rrethina më të vogla dhe që të arrihet në mënyrë direkte deri tek njerëzit dhe t`ju mundësohet komunikimi

Duhet të pranoj se të gjitha këto konsultime kanë ndryshuar mendimin tim. Mendoj se edhe unë sikurse shumica e të rinjve kam menduar se para së gjithash nuk do të kemi çka për të thënë mbi

këtë çështje ngase nuk kemi pasur trauma të mëdha nga lufta. Por, pas kësaj kam kuptuar se sa me rëndësi është që të flitet për këto gjëra dhe që këto gjëra të sqarohen. Unë shpresoj se në të ardhmen një numër i madh i njerëzve do të vi në konsultime të këtilla dhe se kjo është mënyra më e mirë që të shkoni dhe t'i vizitoni rrethinat më të vogla dhe të jeni mobil për të kontaktuar direkt me njerëzit dhe t'ju mundësoni një komunikim të tillë. (Vlatka Kish, Konsultimet lokale me të rinjtë, Daruvar, Kroaci, 27. mars 2010).